



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



KONFERENCA “ZBATIMI I KONVENTËS SË STAMBOLLIT PËRMES PRAKTIKËS GJYQËSORE: DIALOGU GJYQËSOR PËR NJË PËRGJIGJE GJYQËSORE EFEKTIVE”

Prishtinë | 15 mars 2024

Vendi: Hotel Emerald, Prishtinë

Këshilli i Evropës dhe Qendra AIRE organizojnë konferencën me temën “**Zbatimi i Konventës së Stambollit përmes praktikës gjyqësore: Dialogu Gjyqësor për një Përgjigje Gjyqësore Efektive**” me qëllim të ofrimit të një platforme për diskutim ndërmjet Gjykatës Kushtetuese, gjykatave të rregullta dhe sistemit prokurorial për forcimin e dialogut për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Njohuritë e thella të parimeve dhe standardeve evropiane, përfshirë ato të hartuara nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të detyrimeve që rrjedhin nga neni 22 [Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare] të Kushtetutës, e cila përfshin Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (e njohur edhe si Konventa e Stambollit), janë vendimtare për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Konventa e Stambollit është traktati ndërkombëtar më gjithëpërfshirës për të trajtuar dhunën ndaj grave. Konventa njeh se dhuna ndaj grave është një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, të cilat kanë çuar në dominim dhe diskriminim ndaj grave nga burrat dhe në parandalimin e përparimit të plotë të grave.

Zbatimi efektiv i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës së Stambollit kërkon përafrimin dhe harmonizimin e kuadrit legjislativ vendor me standardet e tyre së bashku me kapacitete të përforcuara të institucioneve për të siguruar zbatimin e duhur në praktikë. Në këtë drejtim, vendimet e nxjerra nga Gjykata Kushtetuese për respektimin e Kushtetutës, si gjykatë e shkallës së fundit, kanë ndikim kritik në rendin juridik dhe praktikën gjyqësore vendore në të gjitha nivelet.

Konferenca ka objektiv të dyfishtë:

- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e dialogut gjyqësor dhe ndikimit të tij në parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- Identifikimi i masave dhe hapave konkretë që mund të ndërmerren në afat të shkurtër dhe afatgjatë për të përmirësuar dialogun gjyqësor.

ZBATIMI I KONVENTËS SË STAMBOLLIT PËRMES PRAKTIKËS GJYQËSORE: DIALOGU GJYQËSOR PËR NJË PËRGJIGJE GJYQËSORE EFEKTIVE”

Rendi i ditës

Prishtinë | 15 mars 2024

Vendi: Hotel Emerald, Prishtinë

09:00 - 09:30	Regjistrimi (kafe e shërbyer gjatë regjistrimit)
09:30 - 10:10	Fjalët hyrëse <ul style="list-style-type: none">● Znj. Gresa Caka-Nimani, Kryetare, Gjykata Kushtetuese● Znj. Albulena Haxhiu, Ministre e Drejtësisë dhe Koordinatore Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore● Znj. Biljana Braithwaite, Drejtoreshë, Programi për Ballkanin Perëndimor i Qendrës AIRE● Z. Tankut Soykan, Zëvendës Shef i Zyrës, Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë● Ambasadori/ja në ardhje, Ambasada e Britanisë në Prishtinë (TBC)
10:10 - 10:30	Folësit kryesorë Znj. Dunja Mijatović, Komisionere për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës (Adresim përmes videos)
10:30 - 10:50	Z. Robert Spano, Kryetar, Bordi i Patronëve të Rrjetit Gjyqësor të Kampionëve të Çështjeve Gjinore dhe ish-Kryetar, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
10:50 - 11:00	Pauzë për kafe
11:00 - 11:40	Paneli I Zbatimi i Konventës së Stambollit dhe gjetjet empirike nga analiza e praktikës gjyqësore në Ballkanin Perëndimor Moderatore: Znj. Segolene Chesneau, Menaxhere e projektit, Divizioni për Barazi Gjinore, Këshilli i Evropës <ul style="list-style-type: none">● Z. Mihail Stojanoski, Administrator, Sekretariati i GREVIO-s Reflektime nga raporti mbi <i>Vlerësimin e përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera me standardet e Konventës së Stambollit</i>● Znj. Kosana Beker, Drejtoreshë e Programit, FemPlatz dhe Eksperte Gjinore, Qendra AIRE Reflektime nga raporti “<i>Përgjigjja gjyqësore ndaj femicidit në Ballkanin Perëndimor</i>”● Znj. Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, Gjyqtare, Gjykata Kushtetuese

	Prezantimi i gjetjeve kryesore të raportit “Femicidi në Republikën e Kosovës: Korniza Ligjore dhe Praktika Gjyqësore (2018-2022)”
11:40 - 12:00	Diskutim i hapur
12:00 - 13:30	Dreka
13:30 - 15:00	<p>Paneli II Dialogu Gjyqësor për të Siguruar Luftimin Adekuat të Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje</p> <p>Moderatore: Znj. Ariana Qosaj-Mustafa, Kryetare e Bordit, Rrjeti i Grave të Kosovës</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Znj. Remzije Istrefi-Peci, Gjyqtare, Gjykata Kushtetuese “Zbatimi i Konventës së Stambollit: praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese” ● Z. Albert Zogaj, Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës “Roli i gjykatës në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” ● Z. Naim Qelaj, Avokat i Popullit “Roli i Avokatit të Popullit në ndërtimin e standardeve në përputhje me Konventën e Stambollit për mbrojtjen gjyqësore efikase dhe efektive në rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” ● Znj. Sevdije Morina, Prokurore dhe Koordinatore për veprat penale të dhunës në familje, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit “Vlerësimi i rrezikut nga ana e prokurorëve të rastet e Dhunës në Familje dhe nevoja për përmirësime – Me theks tek vrasjet e grave në Kosovë” ● Znj. Arrita Reznqi, Menaxhere e Programit dhe Koordinatore e Qendrës për Ndihmë Juridike Falas, Instituti i Kosovës për Drejtësi “Roli i shoqërisë civile në luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – rëndësia e ndihmës juridike falas dhe kërkesa për llogaridhënie institucionale”
15:00 - 15:30	Diskutim i hapur
15:30 – 15:45	<p>Përmbledhje dhe mbyllja e konferencës</p> <p>Znj. Gresa Caka-Nimani, Kryetare, Gjykata Kushtetuese</p>